



AKTI I THEMELIT
TE SHOQERISE ANONIME

"BENA - GAS" SH.A.

Sot ne date 14/12/1999 (njemije e nenteqind e nentedhjte e nente) zoterinjte:

1. DURIM BABOCI, lindur ne Vlore me 09/05/1950 dhe banues po aty ne lagjen "Deshmoret", nr. 1175; me shtetesi e kombesi shqiptare;
2. NAPOLON DEDE, lindur ne Vlore me 26/01/1959 dhe banues po aty ne lagjen "Kushtrimi", nr. 480; me shtetesi e kombesi shqiptare;
3. ALBERT BABOCI, lindur ne Vlore me 06/10/1960 dhe banues po aty ne lagjen "28 nentori", nr. 375; me shtetesi e kombesi shqiptare;

hartuan aktin e themelimit si me poshte:

Neni 1

Themelohet shoqeria anonime pa oferte publike me emrin "BENA GAS" SH.A.

Neni 2

Selia e shoqerise do jete ne Vlore ne lagjen "Deshmoret", nr. 1175; ajo mund te krijoje seli dytesore, filiale, agjensi, zyra perfaqesimi ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.

Neni 3

Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj te pakufizuar.

Neni 4


Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj vijuesin:

- Import - eksporti, transporti dhe tregtimi me shumice I Gazit te Lenget te Naftes (GLN); depozitim, perzierjen, ambalazhimin ne bombola dhe ne rezervuare te vegjel te tij;
- Shoqeria mund te kryeje aktivite te tjera tregtare dhe industriale, aktivitet ne fushen e transportit, per vehte ose per llogari te te treteve;
- tregtimi I karburanteve, lubrifikanteve, artikujve industriale dhe ushqimore, I materialeve te ndertimit, makinerive, pajisjeve e pjeseve te kembimit;
- Shoqeria do te kryeje çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e saj te veprimtarise, perfshire pjesmarrjen ne shoqeri me objekt te njejte ose te ngjashem, blerjen e tyre; shoqeria mund te nderhyje si dorezanes, te jape garanci dhe/ose te vere hipoteke.

Neni 5

Kapitali I shoqerise eshte 2.000.000 (dy milione) leke dhe eshte I ndare ne 2.000 (dymije) aksioneme vlere nominale 1.000 (njemije) leke seicili, kapital ky qe nenshkruset prej ortakeve themelues ne raportet vijuese:

1. DURIM BABOCI nenshkruan 400 (katerqind) aksione me vlere te pergjithshme 400.000 (katerqindmije) leke, ekuivalente me 20% te aksioneve te shoqerise;



2. NAPOLON DEDE nenshkruan 800 (teteqind) aksione me vlere te pergjithshme 800.000 (teteqindmije) leke, ekuivalente me 40% te aksioneve te shoqerise;



3. ALBERT BABOCI nenshkruan 800 (teteqind) aksione me vlere te pergjithshme 800.000 (teteqindmije) leke, ekuivalente me 40% te aksioneve te shoqerise.

Ortaket themelues deklarojne se kane depozituar kuoten e tyre ne vleftat e mesiperme konform ligjit nr. 7638 date 19.11.1992.

Neni 6

Nenshkruesit e kapitalit themeltar te shoqerise "BENA GAS" sh.a. deklarojne se menyra e ndarjes se fitimeve si dividente, rregullat per thirrjen dhe menyren e vendimmarrjes se asamblese se aksionareve, zgjedhja e organeve drejtuese te shoqerise, percaktimi i kompetencave te tyre, dhe gjithshka tjeter lidhet dhe funksionimin e shoqerise, jane parashikuar ne statutin bashkengjitur ketij akti themelues.

Neni 7

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbyllet ne 31 dhjetor te çdo viti. Ushtrimi i pare financiar mbyllet ne 31 dhjetor _____.



Neni 8

Kryetar i Keshillit te pare Mbikqyres u zgjodh zoti _____

Neni 9



Keshilli Mbikqyres emeroi I Drejtor te Pergjithshem zotin Durim Baboci. Gjithashtu autorizohet si Drejtor I Pergjithshem te terheqe kapitalin e depozituar per themelimin e shoqerise pas regjistrimit te saj si person juridik ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Tiranës.

Neni 10

Veprimtaria e shoqerise tregtare "BENA GAS" Sh.A. do te kryhet ne perputhje me normat e legjislacioni shqiptar dhe per çdo mosmarreveshje eventuale, gjykate kompetente eshte ajo e rrethit te Vlores.

Neni 11

Kontrata u hartua ne 5 kopje dhe pasi u lexua prej aksionareve, u nenshkrua pa asnje verejtje ne prezence te Noteres JETMIRA VERAJ.



ORTAKET THEMELUES:

1. Durim Babaci
2. Haqdon Selim
3. Ilir Babaci



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE VLORE
NOTERE JETMIRA VERAJ



Repertori Nr. 916
Koleksioni Nr. 661

Vlore, me 18/12/1999

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Vlore, sot ne daten 18 dhjetor 1999 (njemije e nenteqind e nentedhjte e netne), para meje Noteres JETMIRA VERAJ, e regjistruar ne Dhomen e Notereve Vlore, ne zyren time noteriale te ndodhur prane Gjykates se rrethit, u paraqiten personalisht shtetasit shqiptare:

1. DURIM BABOCI, I biri I Hysenit dhe I Kanerines, lindur ne Vlore me 09/05/1950 dhe po aty banues ne lagjen "Deshmoret", nr. 1175; madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar; i njohur prej meje Noteres, per identitetin e te cilit jam e bindur; ;

2. NAPOLON DEDE, I biri I Ligos dhe I Aleksandres, lindur ne Vlore me 26/01/1959 dhe po aty banues ne lagjen "Kushtrimi", nr. 480; madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar; i njohur prej meje Noteres, per identitetin e te cilit jam e bindur; ;

3. ALBERT BABOCI, I biri I Hysenit dhe I Kanerines, lindur ne Vlore me 06/10/1960 dhe banues po aty ne lagjen "28 nentori", nr. 375; madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar; i njohur prej meje Noteres, per identitetin e te cilit jam e bindur; ;

Te paraqiturit deklaruan se kane nenshkruar me vullnet te lire aktin e mesiperm dhe une Noterja, duke qene e bindur per identitetin e te paraqiturve, legalizoj nenshkrimet e tyre ne akt

NOTERE

JETMIRA VERAJ





STATUTI

I SHOQERISE ANONIME

"BENA - GAS" SH.A.

Sot ne date 18/12/1999 (njemije e nenteqind e nentedhjte e nente) zoterinjte:

1. DURIM BABOCI, lindur ne Vlore me 09/05/1950 dhe banues po aty ne lagjen "Deshmoret", nr. 1175; me shtetesi e kombe si shqiptare;
2. NAPOLON DEDE, lindur ne Vlore me 26/01/1959 dhe banues po aty ne lagjen "Kushtrimi", nr. 480; me shtetesi e kombesi shqiptare;
3. ALBERT BABOCI, lindur ne Vlore me 06/10/1960 dhe banues po aty ne lagjen "28 nentori", nr. 375; me shtetesi e kombesi shqiptare;

kane themeluar shoqerine anonime pa oferte publika, te emertuar "BENA GAS", e cila do te funksionoje sipas percaktimeve te ketij statuti me permbajtjen e meposhtme dhe te legjislacionit shqiptar.

KAPITULLI I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

EMERTIMI - SELIA - KAPITALI THEMELTAR - KOHEZGJATJA

NENI 1

"BENA GAS" sh.a. eshte shoqeri anonime pa oferte publike e cila fiton

personalitet juridik qe nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Faktit Tirane.



NENI 2

Emertimi i shoqerise do jete "BENA GAS" SH.A.

Selia e shoqerise do jete ne Vlore ne lagjen "Deshmoret", nr. 1175.

Selia e shoqerise mund te ndryshohet me vendim te asamblese se zakonshme te aksionareve.

Shoqeria mund te krijojë dege, filiale, perfaqesi dhe agjensi ne qytete te tjera te Republikës se Shqipërisë dhe jashte saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete vijuesi:

- Import - eksporti, transporti dhe tregtimi me shumice i Gazit te Lenget te Naftes (GLN); depozitimin, perzierjen, ambalazhimin ne bombola dhe ne rezervuare te vegjel te tij;
- Shoqeria mund te kryeje aktivitete te tjera tregtare dhe industriale, aktivitet ne fushen e transportit, per vehte ose per llogari te te treteve;
- tregtimi i karburanteve, lubrifikanteve, artikujve industriale dhe ushqimore, i materialeve te ndertimit, makinerive, pajisjeve e pjeseve te kembimit;



• Shoqeria do te kryeje çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e saj te veprimtarise, perfshire pjesmarrjen ne shoqeri me objekt te njejte ose te ngjashem, blerjen e tyre; shoqeria mund te nderhyje si dorezanes, te jape garanci dhe/ose te vere hipoteke.



NENI 4

Kapitali I shoqerise eshte 2.000.000 (dy milione) leke dhe eshte i ndare ne 2.000 (dymije) aksioneme vlere nominale 1.000 (njemije) leke seicili, kapital ky qe nenshkruhet prej ortakeve themelues ne raportet vijuese:

1. DURIM BABOCI nenshkruan 400 (katerqind) aksione me vlere te pergjithshme 400.000 (katerqindmije) leke, ekuivalente me 20% te aksioneve te shoqerise;
2. NAPOLON DEDE nenshkruan 800 (teteqind) aksione me vlere te pergjithshme 800.000 (teteqindmije) leke, ekuivalente me 40% te aksioneve te shoqerise;
3. ALBERT BABOCI nenshkruan 800 (teteqind) aksione me vlere te pergjithshme 800.000 (teteqindmije) leke, ekuivalente me 40% te aksioneve te shoqerise.

NENI 5

Shoqeria do ushtroje aktivitetin e saj per nje afat te pakufizuar.

KAPITULLI II-te

DREJTIMI I SHOQERISE DREJTORI - KESHILLI MBIKQYRES

NENI 6

Drejtoria e shoqerise ne kuptim te ligjit do jete e perbere vetem prej Drejtorit.

Drejtori eshte pergjegjes per drejtimin dhe mirefunksionimin e shoqerise, administrimin e pasurise dhe mbrojtjen e interesave te saj. Ai aplikon metodat dhe menyrat qe i konsideron me te frutdhese, me te pershtatshme e me efektive per te realizuar objektivat e caktuara nga Keshilli Mbikqyres dhe Asambleja e Aksionareve.





Drejtori ka kompetenca te plota per te vepruar ne çdo rrethane ne emer te shoqerise dhe kufizimet e tij konsistojne vetem ne ato kompetenca qe ligji ose ky statut I lene eskuzivisht asamblese se aksionareve dhe/ose Keshillit Mbikqyres. Drejtori ushtron kompetencat e tij ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise.

Drejtori zgjidhet me votat pro te te pakten 2/3 se anetareve te Keshillit Mbikqyres per tre vjet me te drejte rizgjedhjeje. Drejtor I pare emerohet zoti DURIM BABOCI.

Drejtori mund te shkarkohet para afatit me votat pro te te pakten 2/3 te anetareve te Keshillit Mbikqyres. Kjo mund te ndodhe kur konstatohet se eshte kryer nje faj I rende prej tij, kur eshte konstatuar paaftesi ne ushtrimin e funksioneve te veta ose kur asambleja ka humbur besimin.

NENI 7

Drejtori ka te drejte te ushtroje keto kompetenca:

- propozon vendime per aprovim para keshillit Mbikqyres;
- emeron dhe shkarkon zevendesat dhe keshilltaret e tij, drejtoret e departameve, kryetaret e degeve, drejtoret e filialeve dhe pergjegjesit e sektoreve; percakton kategorite e pagave te tyre dhe ndryshimet eventuale;
- miraton strukturen e stafit administrativ dhe punonjeseve te shoqerise dhe kualifikimin e nevojshem sipas kategorive perkatese dhe masen e shperblimit;
- perfaqeson shoqerine ne raportet me te tretet;
- miraton prokurimet deri ne 10.000 (dhjetemije) USD; per prokurime mbi kete shifer nevojitet miratimi I Keshillit Mbikqyres;
- nenshkruan kontrata e marreveshje ne emer te shoqerise me vlere deri ne 10.000 (dhjetemije) dollare; per kontratat mbi kete shifer nevojitet miratimi I Keshillit Mbikqyres;
- mund te delegeje pjese te kompetencave te tij;
- miraton rregulloren e brendshme;
- miraton kushtet e kontrates se punes;
- ka fuqi vendimore per fushatat e marketingut, tarifat dhe promocionet gjate tyre;





- merr vendime lidhur me politiken financiare te shoqerise, çeljen apo mbylljen eventuale te llogarive bankare;
- percakton sasine e rezervave te shoqerise dhe menyren e perdorimit te tyre.
- per prokurime mbi kete shifer nevojitet miratimi I Keshillit Mbikqyres;

NENI 8

Keshilli Mbikqyres emerohet nga asambleja e zakonshme e aksionereve dhe afati I mandatit te anetareve te tij eshte 3 (tre) vjet. Keshilli Mbikqyres perbehet prej 3 (tre) anetaresh. Ata mund te riemerohen. Ne çdo moment asambleja e zakonshme e aksionereve mund te shkarkoje anetaret e Keshillit Mbikqyres. Mbledhja e Keshillit Mbikqyres eshte e vlefshme vetem kur jane te pranishem te tre anetaret e tij. Votat e anetareve jane te barabarta. Anetaret e Keshillit te pare Mbikqyres jane shtetasit NAPOLON DEDE, ALBERT BABOCI dhe ADRIAN VRESHTAZI. Kryetar I Keshillit te pare Mbikqyres u zgjodh zoti _____

Mbledhja e Keshillit Mbikqyres thirret prej Kryetarit te tij ose prej Drejtorit. Njoftimit per mbledhjen duhet bere te pakten ___ dite para dhe me njoftim me shkrim, ku percaktohet vendi dhe ora e mbledhjes, rendi I dites dhe materialet qe do te shqyrtohen. Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk duhet te marrin pjese ne Keshilla te tjere Mbikqyres apo ne Drejtori te shoqerive te tjera anonime qe ushtrojne te njejten veprimtari ne Republikën e Shqipërisë. Ne rast se nje ose disa vende te anetareve te Keshillit Mbikqyres mbeten bosh per shkak te vdekjes, shkarkimit ose doreheqjes, zevendesimi I tyre duhet bere brenda jo me vone se 3 (tre) muaj. Anetari I Keshillit Mbikqyres I emeruar si zevendes I nje anetari qeter, perfundon mandatin e anetarit paraardhes.



NENI 9

Keshilli Mbikqyres ka keto kompetenca:



- Zgjedh Drejtorin me votat e te pakten 2/3 te antareve;
- Shkarkon Drejtorin me votat e te pakten 2/3 te antareve;
- Miraton transferimin e aksioneve;
- Pergatit bilancin vjetor dhe ja paraqet per miratim Asamblese se Zakonshme.
- Miraton strategjine e zhvillimit dhe projektet e reja strategjike.
- Miraton investimet mbi 1.0.000 dollare amerikane.
- Miraton marrjen e huave afatmesme dhe afatgjata, dhenien e dorezanive ose garancive te tjera kur keto te fundit tejkalojne vepritmarine e zakonshme te shoqerise.
- Miraton strukturen e shoqerise, strukturen dhe masen e pagave.
- Kontrollon investimet mbi 1.0.000 dollre amerikane ose ekuivalente.
- Miraton strukturen e tarifave baze te sherbimit.
- Ushtron kontroll mbi Drejtorine per administrimin e mire te shoqerise. Ka te drejte te kryeje ne cdo kohe verifikime dhe kontrole qe i gjykon te nevojshme dhe te kerkoje te njihet me dokumentat qe i gjykon te nevojshme per plotesimin e detyres se tij.
- Kerkon raport me shkrim nga Drejtoria per cdo 3 muaj dhe raportin vjetor brenda 3 mujorit te pare te vitit pasardhes.
- Jep paraprakisht pelqimin per marreveshjet qe mund te beje shoqeria me nje pjestar te Drejtorise apo Keshillit Mbikqyres apo kur keta te fundit kane lidhje pronesie apo punesimi me nje subjekt tjetër qe ben marveshje me shoqerine. Ne kete rast antari i Keshillit Mbikqyres nuk merr pjese ne votim, gjithashtu ai eshte i detyruar te njoftoje Keshillin Mbikqyres per cdo marreveshje qe ka lidhje me te ne format e mesiperme.
- Keshilli Mbikqyres mund te caktoj shperblime te jashtezakonshme per sherbime apo detyra qe u ngarkohen anetareve te tij.
- Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk kane te drejte te kontraktujne ne cfaredo forme per te marre hua nga shoqeria, te japin nepermjet saj paradhenie, dorzani, apo garanci per detyrime per te trete.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA E AKSIONAREVE

NENI 10

Mbledhja e asamblese se aksionareve thirret nga Keshilli Mbikqyres ose nga Drejtori. Gjithashtu ajo mund te thirret nga aksionaret qe zoterojne te



te pakten 1/10 e aksioneve, nga eksperti kontabel i autorizuar, ne mungese te te pareve, nga likuidatori kur shoqeria eshte ne likuidim, ose nga mandat rabajtasi i caktur nga gjykata.

Njoftimi per mbledhjen e asamblese behet me leter rekomande ne adrese te cdo aksionari e cila duhet te mbrije te pakten 15 dite perpara dates se mbledhjes. Njoftimi duhet te permbaje rendin e dites, daten dhe vendin e mbledhjes. Gjithashtu jo me pak se 15 dite perpara vihen ne dispozicion te aksionereve keto dokumenta:

- teksti i projekt rezolutave te paraqitura
- pasqyre permbledhese e gjendjes se shoqerise gjate vitit financiar te kaluar, si dhe nje pasqyre permbledhese e rezultateve te 5 viteve te fundit.
- raportin e eksperteve kontabel te autorizuar
- emri, mbiemri, te dhenat biografike dhe c.v., kur ka emerime ne rendin e dites.

Mbledhjet e Asamblese qe thirren ne menyre te parregullt mund te anulohen perjashtojte kur te gjithe aksionaret jane prezent.

Votat e aksionareve kane peshe proporcionale me kuoten e aksioneve qe ata zoterojne. Cdo aksioner jep te drejten e nje vote. Cdo aksionar mund te perfaqesohet ne asamble nepermjet nje aksionari tjeter ose nepermjet nje perfaqesuesi duke qene keta te autorizuar me prokure noteriale.

NENI 11

Asambleja e zakonshme

Asambleja e zakonshme merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare, vetem neqoftese aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne te pakten 1/3 e aksioneve. Ne rast se kjo mbledhje nuk realizohet, ne te dyten nuk kerkohej asnje lloj quorumi. Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar. Mbledhjet e Asamblese se zakonshme behen te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar. Mbledhjet e Asamblese verbalizohen dhe materialet ruhen. Vendimet e Asamblese se zakonshme mund te jene edhe qarkulluese. Per te realizuar kete lloj vendimi shpermdahet projekti, mblidhen verejtjet dhe me pas firmoset vendimi perfundimtar pa u mbledhur aksioneret fizikisht ne nje salle. Asambleja e zakonshme merr cdo vendim perjashtuar ato qe jane ne kompetence te Asamblese se Jashtezakonshme.

Asambleja e zakonshme ka keto kompetenca:





Emeron Keshillin Mbikqyres dhe Kryetarin e tij.
Percakton shperblimin e antareve te Keshillit Mbikqyres.
Miraton politiken e Pergjithshme te zhvillimit te shoqerise.

Miraton pjesemarrjen ne shoqeri te tjera.

Miraton ekspertet kontabel.

- Degjon dhe miraton raportin vjetor te Drejtorit se bashku me llogarite dhe raportin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe merr vendimet per te gjitha ceshtjet financiare te vitit te kaluar.
- Miraton marreveshjet qe behen midis shoqerise dhe nje anetari te Drejtorise apo te Keshillit Mbikqyres, si dhe te shoqerise me subjekte te tjere qe kane lidhje pronesia me personat e siperpermendur.

NENI 12

Asambleja e Jashtezakonshme

Asambleja e Jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme vetem neqoftese aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne ne mbledhjen e pare te pakten 2/3 e aksioneve dhe ne te dyten 1/2 e aksioneve. Ne mungese te ketij qourumi mbledhja e dyte e asamblese mund te shtyhet per nje date te mevonshme, jo me te larget se dy muaj, nga data e thirrjes se pare. Ajo merr vendime me nje shumice votash prej 3/4 qe u perkasin aksionareve te pranishem ose te perfaqesuar. Mbledhjet e Asamblese se jashtezakonshme verbalizohen dhe materialet ruhen.

Asambleja e jashtezakonshme ka keto kompetenca:

Te ndryshoje statutin e shoqerise.

Te vendose per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit ne baze te raportit te paraqitur nga Keshilli Mbikqyres dhe te procedurave te percaktuara ne ligj.

- Te heqe te drejten e perparesise se nenshkrimit , n.q.s e sheh te arsyeshme ne rastin e zmadhimit te kapitalit.

- Te vendose shkrirjen e shoqerise sipas kushteve dhe procedurave te percaktuara ne ligj.

- Te ndryshoje kompetencat e Keshillit Mbikqyres dhe Drejtorit te Pergjithshem.





KAPITULLI IV

NDRYSHIMI I KAPITALIT THEMELTAR – TRANSFERIMI I AKSIONEVE

NENI 13 Zmadhimi I kapitalit

Kapitali themeltar zmadhohet nepermjet emetimit te aksioneve te reja ose nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve ekzistuese. Kjo rritje e kapitalit behet vetem me pelqimin unanimit te aksionareve, me perjashtim te rastit kur kjo realizohet me perfshirjen e rezervave, te fitimeve apo primeve te emetimit.

NENI 14

Asambleja e jashtezakonshme eshte I vetmi organ kompetent per te vendosur mbi zmadhimin e kapitalit sipas raportit te drejtorise. Ne rast te zmadhimit te kapitalit me perfshirjen e rezervave, te fitimeve ose primeve te emetimit, asambleja vendos sipas kushteve te quorumit dhe shumices sipas nenit 11 te ketij statuti.

NENI 15

Aksionaret kane te drejte perpariesie ne nenshkrim per rritjen e kapitalit me para ne dore, proporcionalisht me shumen e aksioneve qe zoterojne. Asambleja qe vendos per zmadhimin e kapitalit mund te heqe te drejten e perpariesise se nenshkrimit, vendim qe merret ne baze te raportit te Drejtorit qe te ekspertit kontabel. Drejtesia e nenshkrimit duhe ushtruar brenda 20 diteve nga dita e celjes se nenshkrimit.

NENI 16

Zvogelimi i kapitalit autorizohet ose vendoset nga asambleja e jashtezakonshme.



Projekti I zvogelimit te kapitalit i komunikohet ekspertit kontabel te autorizuar 45 dite para mbledhjes se asamblese se aksionareve.

NENI 17 Transferimi i aksioneve

Aksionet e shoqerise do jene ne formen nominative. Aksioni nominativ u transferohet te treteve dhe personit juridik emetues nepermjet - nje transferimi ne regjistrat, qe shoqeria mban per kete qellim dhe qe permba jne treguesit perkates te operacioneve te transferimit dhe te shjnderrimit te aksioneve.

NENI 18

Aksionet jane te tregtueshme vetem pas regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe ne rast zmadhimi te kapitalit pas regjistrimit te ketij zmadhimi.

Me perjashtim te rasteve te trashegimise, transferimi i pronesise se aksioneve i nenshtrohet te drejtes se parablerjes se aksionareve.

Kur emetohen aksione te reja te shoqerise, zbatohet perparesia ne nenshkrim e aksionareve proporcionalisht me aksionet qe zoterojne. Ne rast se aksionaret terhiqen nga kjo e drejte, te tretet fitojne te drejten per t'i blere ato me te njejtat kushte.

Ne rast se ndonjeri nga aksionaret do te shese aksionet e tij, ai eshte i detyruar t'i ofroje ato se pari tek aksionaret e tjere te shoqerise me cmim dhe kushte shitjeje te percaktuar nga ai vete. Numri i aksioneve me cmimin e shitjes, i ofrohen se pari aksionareve ekzistues brenda shoqerise me te drejten e perparesise ne nenshkrim, proporcionalisht me shumen e aksioneve qe zoterojne.

Ne rast se aksionaret terhiqen nga kjo e drejte, te tretet fitojne te drejten per t'i blere ato me te njejtat kushte.

Aksionari shites nuk ka te drejte te shese tek te tretet me kushte me favorizuese se ato qe u ka ofruar aksionareve.

Ne rast se aksionari shites nuk gjen bleres te trete me cmimin e pare te ofruar dhe vendos te shese me cmim me te ulet, rifillon proceduren e mesiperme.

NENI 19

Aksionet mund ti transferohen cdo personi fizik apo juridik, shqiptar apo te huaj.

Keshillit mbikqyres duhet t'i paraqitet nje kerkese ku percaktohet identiteti i plote i personave fizike ose juridike qe jane ofruar si bleresa, numri i aksioneve qe parashikon transferimi i pronesise dhe cmimi i ofruar.

Miratimi I Keshillit Mbikqyres konsiderohet i dhene edhe kur ky Keshill nuk jep pergjigje me kalimin e tre muajve nga data e paraqitjes se kerkeses.

KAPITULLI V

KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 20


Eksperti kontabel

Kontrolli financiar ushtrohet nga nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar, te cilet emerohen nga Asambleja e Zakonshme dhe kryejne funksionin e tyre ne pajtim me ligjin. Eksperti i pare kontabel emerohet zj. LAURETA FILIPI.

Ne cdo kohe te vitit, ekspertet kontabel te autorizuar se bashku ose vec e vec bejne te gjitha verifikimet e kontrollet qe i gjykojne te domosdoshme dhe mund te shfrytezojne ne vend te gjithe dokumentacionin e vleresuar si te dobishme ne ushtimin e funksionit te tyre dhe ne vecanti kontratat, librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e procesverbaleve. Ekspertet kontabel informojne Drejtorin e Pergjithshem dhe Keshillin Mbikqyres per:

- Kontrollet, verifikimet dhe sondazhet qe kane kryer.
- Pjeset e bilancit dhe te dokumentave te tjera te kontabilitetit ku ata jane verejtje.
- Parregullsite dhe pasaktesite qe kane zbuluar.

Ekspertet kontabel te autorizuar thirren ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres kur mbyllin llogarite e vitit financiar si dhe ne mbledhjen e Asamblese. Ata jane pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu edhe ndaj te treteve per pasojat qe rrjedhin per fajin dhe nenvleftesimin e tyre gjate ushtrimit te funksioneve qe kane. Honoraret e eksperteve kontabel te autorizuar i ngarkohen shoqerise. Keshilli Mbikqyres me rastin e miratimit te eksperteve miraton edhe masen e shperblimit te tyre.



NENI 21

Ekspertet kontabel te autorizuar jane pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu edhe ndaj te treteve per pasojat e ardhura nga veprimet e tyre te fajshme.



KAPITULLI VI

PRISHJA E SHOQERISE

NENI 22

Prishja e shoqerise vendoset nga asambleja e jashtezakonshme. Ne qofte se si pasoje e humbjeve te konstatuara ne dokumentet kontabel, kapitalet e shoqerise behen me te vogla e gjysma e kapitalit themeltar, shoqeria detyrohet, brenda 4 muajve nga miratimi i bilancit financiar ku eshte konstatuar humbja, te therrase asamblene e jashtezakonshme per te vendosur nese ka vend per prishjen e shoqerise. Ky vendim merret me shumicen e votave qe kerkohen edhe per ndryshimet ne statut. Ne mungese te mbledhjes se asamblese se jashtezakonshme, çdo i interesuar mund te kerkoje ne rruge gjyqesorer prishjen e shoqerise.

NENI 23

Ne kete rast ajo vihet ne likuidim. Likuidimi behet ne pajtim me dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare". Asambleja e Jashtezakonshme cakton likuidatoret duke u percaktuar edhe fuqite qe ata do te kene.



KAPITULLI VII

DISPOZITA PER FUNDIMTARE

NENI 24

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron ne 31 Dhjetor te cdo viti. Përfshirë ushtrimi i pare financiar përfshin kohen nga datat e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar deri me 31 Dhjetor.

NENI 25 Bilanci vjetor

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore. Per ndjekjen e gjendjes financiare Drejtori sipas struktures dhe permbajtjes se percaktuar ne planin kontabel pergatit raportin mbi gjendjen financiare cdo tremujor dhe ate vjetor. Ne mbylljen e cdo viti financiar hartohet inventari i pasurise dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, per kontabilitetin si dhe raporti vjetor mbi gjendjen financiare te shoqerise gjate ushtrimit te kaluar, ku parashikohen edhe ndryshimet ne te ardhmen, si dhe veprimtarite e tjera te shoqerise.



Keto dokumenta i jepen ekspertit kontabel 1 muaj perpara mbledhjes se Asamblese se Aksionareve, i cili ben komentet e veta ne nje raport te vecante.

NENI 26 Miratimi i bilancit

Raporti per gjendjen financiare te shoqerise i detajuar per te gjitha operacionet si dhe per gjendjen e administrimit te shoqerise paraqitet nga Drejtori, ne fund te vitit financiar ne Keshillin Mbikqyres te shoqerise, i cili e miraton dhe ia paraqet Asamblese se zakonshme te aksionareve.

NENI 27 Rezultati i ushtrimit financiar dhe rezervat

Rezultati i ushtrimit percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit duke përfshire ne keto te funditr edhe amortizimet, provizionet dhe taksat. Nga fitimet e ushtrimit te pakesuara, kur eshte rasti me humbjet e meparshme, hiqen te pakten 5% per te krijuar rezerven e domosdoshme. Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme



pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 15 % te kapitalit themeltar.

Nga fitimet e ushtrimit te pakesuar, kur eshte rasti me humbjet e meparsme shoqeria do te heqe jo me shume se 85% per krijimin e rezervave per zhvillim. Asambleja e zakonshme ne rast nevoje mund te formoje edhe fonde te tjera. Shuma e fitimeve te mbetura pas krijimit te rezervave te krijuara me siper perfaqson dividentin. Aksionaret kane te drejten te marrin pjesen e fitimit te destinuar per ndarje nga Asambleja e zakonshme, propocionalisht me pjesemarjet e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 28

Pergjegjesite ndaj shtetit

Shoqeria ka llogarite e saj bankare dhe pergjigjet me fondet e saj per taksat dhe detyrimet e tjera ndaj shtetit.

NENI 29


Transformimi ne shoqeri me oferte publike

Shoqeria 'B E N A GAS SH, A, pa oferte publike mund te transformohet ne shoqeri me oferte publike. Vendimi per kete transformim merret nga Asambleja e Jashtezakonshme.

NENI 30

Fshehtesia e informacionit dhe konfidencialiteti

Te gjitha aksioneret, anetaret e Keshillit Mbikqyres, Drejtori i Pergjithshem dhe te gjitha te punesuarit ne shoqerine 'B E N A GAS SH.A. Jane te detyruar te ruajne fshehtesine e cdo informacioni apo te dhene ne lidhje direkte ose indirekte me shoqerine, per te cilen ata vihen ne dijeni gjate ushtrimit te aktivitetit te tyre, ose ne menyre te terthorte. Ata duhet te marrin te gjitha masat e nevojshme dhe te zbatojne procedurat e percaktuara per te penguar perhapjen e cfaredolloj forme te informacionit. Te gjitha aksionaret, anetaret e Keshillit Mbikqyres, Drejtori dhe te gjitha te punesuarit ne shoqerine 'B E N A GAS SH.A, pergjigjen per pasojat e



demshme qe i shkaktohen shoqerise nga perhapja e paautorizuar e informacionit.



NENI 31
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet midis aksionareve, te punesuarve dhe personave te trete kontraktues, ne rast se zgjidhja e ceshtjes nuk arrihet me mirekuptim, ajo behet objekt i gjykates kompetente.

NENI 32
Marredheniet me punonjesit

Marredheniet e shoqerise me punonjesit rregullohen sipas legjislacionit te punes ne Republiken e Shqiperise.

NENI 33
Falimentimi, paaftesia ose vdekja e nje aksioneri

Shoqeria nuk priset kur falimenton, vdes ose shfaq paaftesi njeri prej aksionareve.

NENI 34
Vula dhe stema

Shoqeria ka vulen e vet, (e rrumbullaket dhe ne te anash perimetrit shkruhet 'BENI GAS SH. A VLORE' ndersa ne mes eshte figura e stemes se shoqerise). Cdo departament, filial, dege, ose perfaqesi ka gjithashtu vulen e vet, me specifikimet perkatese, te ndryshme nga ato te shoqerise. Stema e shoqerise perbehet nga nje shqiponje. Stema paraqitet bashkangjitur ketij statuti.

NENI 35
Gjuha dhe kopjet origjinale

Ky statut eshte hartuar ne gjuhen shqip dhe italisht, ne 5 (pese) kopje

Gjithshka nuk eshte parashikuar ne kete statut do te trajtohet sipas dispozitave te ligjit nr. 7638 date 19/11/1992 "Per shoqerite tregtare" dhe sipas legjislacionit civil shqiptar ne teresi.

ORTAKET THEMELUES:

1. Junina Babou
 2. Nagala Babou
 3. Alket Babou
-